

**Hyrë Tejeci Murati\*\***

## **Mediat lokale në Kosovë, gjendja dhe sfidat**

### **Abstrakti**

Në Kosovë janë 82 radio dhe 21 televizione që kanë licencë deri në fund të vitit 2016. Katër radio dhe tre televizione kanë frekuencë nacionale; 14 radio dhe 12 televizione janë rajonale dhe 64 radio dhe gjashtë televizione janë lokale. Shumica e mediave elektronike lokale dhe rajonale transmetojnë program në gjuhën shqipe, por disa transmetojnë program edhe në gjuhën serbe, turke, rome. 56 TV të tjerë të licencuar, ofrojnë program vetëm përmes operatorëve kabllorë. Rezultatet e një hulumtimi në shtatë rajone në Kosovë, tregojnë se disa media lokale janë mbyllur dhe shumë të tjera rrezikojnë të mbyllen, për shkak të gjendjes së keqe financiare dhe infrastrukturës së dobët të tyre në përgjithësi. Ato operojnë me pak staf dhe me kushte minimale për punë. Shumë prej tyre kanë statusin e Organizatës Joqeveritare dhe sigurojnë financimin përmes projekteve.

Kriza financiare e këtyre mediave reflekton në të ardhurat për gazetarë të tyre. Rrjedhimisht kjo ndikon edhe në konkurrencë dhe produktet që ofrojnë. Një vështrim i faqeve të tyre në internet (disa që kanë), çon në përfundim se ato nuk kanë produkte të veta, por japin informacione për zhvillime në përgjithësi, duke u shndërruar në portale që i ngjajnë shumë njëri tjetrit.

Në këtë punim, jam përqendruar të pasqyroj gjendjen aktuale të mediave lokale në Kosovë, mënyrën e financimit të tyre, kushtet e punës, numrin e punëtorëve dhe sfidat kryesore që mund të kenë.

**Fjalë kyçe:** mediat lokale, financiare, konkurrencë, gjendje, sfidë

---

\* Kolegji AAB , Prishtinë, Email: htejeci@hotmail.com

## Hyrje

Mediat lokale në Kosovë sot janë në krizë ekzistenciale. Shumica prej tyre përballen me numër të vogël të gazetarëve, për shkak të gjendjes së rënduar financiare. Kjo reflekton edhe në cilësinë e programit, e pastaj edhe në konkurrencën mes tyre. Nga ana tjetër nevoja për to mbetet e rëndësishme.

Një analizë e mediave lokale, radio dhe televizione në Kosovë, tregon se shumica prej tyre kanë staf të vogël, mbahen me të hyra nga marketingu, disa financohen me projekte, herë pas here, e disa, janë detyruar të ndryshojnë format, në mënyrë që të mbijetojnë.

Me dixhitalizim mediat lokale duhet të jenë më profesionale në mënyrë që të jenë konkurrencte në treg. Në një epokë të audiencave të fragmentuara, është shumë e rëndësishme që të kuptohen më mirë nevojat e audiencës.<sup>1</sup> Ndryshe rrezikojnë të dobësohen deri në mbyllje, siç edhe janë mbyllur tashmë disa në Kosovë.

Për këtë punim kam intervistuar 51 pronarë të mediave lokale, radio dhe televizioneve, duke përfshirë edhe pronarë të mediave lokale të minoriteteve në Kosovë.


### **Kriza financiare e medias lokale në Kosovë**

Shumë media lokale në Kosovë, sidomos radio, për të cilën bizneset nuk tregojnë shumë interes, janë shtrënguar të zvogëlojnë stafin, disa janë mbyllur fare, për shkak të gjendjes së keqe financiare. Në formatet siç janë themeluar, shumica prej tyre si Organizata Joqeveritare, nuk mund të kenë qëndrueshmëri edhe më tutje, sepse oferta mediale është shumë e madhe tani. Për shembull, Radio Helix në Prizren, Radio Energji, Radio Shqip FM në Gjilan nuk kanë asnjë punëtor. Pronarët e tyre thonë se kanë një kompjuter nga i cili transmetojnë muzikë gjatë gjithë kohës, meqë kanë licencë nga KPM deri në fund të dhjetorit 2016.

---

<sup>1</sup>Crow, Andrew. To survive today's media business, local stations need more than ratings, Visioncritical, 2016,

Figura 1. Media të mbyllura



Ka informacione që edhe në qytete më të vogla të Kosovës janë mbyllur disa media lokale, për shkak të krizës financiare. Shumë media lokale kishin (ri)nisur punën menjëherë në qershor të 1999, pas hyrjes së trupave të NATO-s në Kosovë. Mbi 17 vjet pas, gjendja e tyre është shumë më e rënduar.

Media lokale	Stafi themelues	Stafi aktual
Radio Prizreni	25	1
Radio Gjakova	20	11
Radio Peja	14	8
RTV Mitrovica	17	2
Radio Besa	19	5
Radio Ylberi	17	10

Figura 2. Zvogëlim i stafit

Siç shihet edhe në figurën e më sipërme, ka një zvogëlim të dukshëm të numrit të punëtorëve në media lokale. Për shembull, Radio Prizreni, pas 41 vjetësh të themelimit, sot mbahet me vetëm një punëtor teknik, thotë drejtori Mehdiulki Çibo.<sup>2</sup>

RTV Tema në Ferizaj ka një qëndrueshmëri më stabile. Prej vitit 2002 nuk ka pasur lëvizje shumë të punëtorëve. Drejtori Visar Hoti thotë se të hyrat i sigurojnë edhe nga reklamat që marrin nga komuna. Pashmangshëm krijohet edhe varshmëri gjatë raportimit. Dy forma të

<sup>2</sup> Radio Prizreni është themeluar si Radiostacion i parë në Kosovë pas Luftës së Dytë Botërore (1945). Në vitin 1975 Radio Prizreni e rifilloi punën si radio stacion rajonal...

trysnisë së tërthortë, që përdoren për të ushtruar kontroll mbi mediat janë reklamat dhe fondet nga qeveria.<sup>3</sup>

Të gjithë pronarët e mediave të intervistuar kanë thënë se përballen me krizë të rëndë financiare. Disa prej tyre sigurojnë të hyra nga marketingu e disa sigurojnë projekte nga institucione komunale apo asociacione të ndryshme. Sot kompani biznese kanë oferta të shumta mediale për plasimin e produkteve të tyre, me qëllim që të mbërrijnë më lehtë te konsumatori. Një prej mediave lokale në Prishtinë, Radio Vala Rinore, është e vetmja që mbahet me të hyrat **vetëm** nga marketingu. Gjatë intervistës me drejtorin Ekrem Çitaku, kuptuam se shumë kompani dhe agjenci biznese bëjnë parapagim në këtë radio për reklamimin e produkteve të tyre.<sup>45</sup> Skema përmban më shumë muzikë, me fokus të rinjtë. Nuk përfshinë aktivitete politike. Megjithatë, ka mungesë të stafit profesional, thotë drejtuesi Çitaku.

Hapësira për reklama është e kufizuar në mediat lokale. Disa media lokale fajësojnë sidomos institucionet komunale që reklamat i dërgojnë në media në mënyrë selektive. Kjo çështje është e rregulluar me ligjin për Komisionin e Pavarur për Media në Kosovë, më saktë, me Rregulloren për Komunikimet Komerciale AudioVizuale.<sup>6</sup> Megjithatë, tregu mediatik është zgjeruar aq shumë, sa nuk duket të ketë transparencë rreth financimit të mediave.

### **Mediat e komuniteteve pakicë**

Në Kosovë janë 3 televizione dhe 15 radio lokale vetëm në gjuhën serbe, 3 radio lokale janë në gjuhën boshnjake, 2 radio lokale në gjuhën turke, 1 në gjuhën gorane, 1 në gjuhën rome, 5 televizione dhe 20 radio transmetojnë të paktën në dy apo tri gjuhë.

---

<sup>3</sup> IREX. The Development of Sustainable Independent Media in Europe and Eurasia, 2013, f. 95

<sup>4</sup> Radio Helix, F 104.4

<sup>5</sup> (<http://www.radiovalarinore.com/>)

<sup>6</sup> Ligji i KPM, Nr.04/L-44, (<http://kpm-ks.org/materiale/dokument/1473429643.4765.pdf>)

Mediat në veri financohen nga qeveria e Serbisë dhe nga projekte ndërkombëtare. Ato janë të regjistruara dhe kanë licencë të Komisionit të Pavarur për Media në Kosovë.<sup>7</sup> Gazetarë të mediave në veri, të cilët marrin paga nga qeveria e Serbisë, janë të obliguar të raportojnë edhe për media tjera serbe në Kosovë, thotë Maja Fiqoviç, drejtoreshë e Radio Kosovska Mitrovica në veri të Kosovës. Radio Romano Avazo në Prizren transmeton program në gjuhën rome. Ka 6 punëtorë, të cilët aktualisht nuk kanë paga për shkak të ndërprerjes së financimit të projekteve. Edhe mediat tjera rome, boshnjake e ka të njëjtin problem. Deri tani këto radio lokale janë paguar nga ambasada dhe disa organizata të huaja që veprojnë në Kosovë. Mediat në gjuhën turke financohen kryesisht nga donacione turke.

### **Televizionet lokale dhe rajonale**

Situatë e ngjashme është edhe në televizionet lokale në Kosovë. Me TV-të bizneset bashkëpunojnë më lehtë, sesa me radiot, për reklamimin e produkteve të tyre. Megjithatë, jo kënaqshëm. Për shembull, Televizioni i Prizrenit siguron të hyrat kryesisht nga marketingu dhe është detyruar të shkurtojë këtë vit në 12 numrin e punëtorëve, nga 30 sa kishte në 2005, thotë drejtori Mifail Bytyqi. Në Gjakovë TV Syri, edhe pse është i vetmi televizion lokal, konkurrenca e madhe përmes operatorëve tjerë, nuk i krijon hapësirë të zhvillojë punën.

---

<sup>7</sup>Komisioni i Pavarur për Media, (<http://www.kpm-ks.org/?faqe=121&gjuha=>)




Figura 3. Zvogëlimi i numërit të punëtorëve në TV lokale

Udhëheqësit e mediave lokale në Kosovë, të intervistuar për këtë punim, pa përjashtim, kanë thënë se rrjetet sociale dhe portale të shumta të hapura, sipas tyre, pa kritere, kanë dëmtuar rëndë mediat lokale. Pavarësisht se shumica e mediave lokale, si radiot ashtu edhe televizionet, kanë hapur faqe të tyre në internet, ato nuk arrijnë të mbahen, të përditësojnë informacion, pikërisht për shkak të financave të këqija që kanë.

### **Ndikimi i medias lokale**

Avancimi i teknologjisë dhe ofertat të mëdha mediale ka lënë nën hije mediat lokale në Kosovë. Ato që arrijnë të mbijetojnë duhet t'i nënshtrohen edhe procesit të dixhitalizimit shumë shpejt. Komisioni i Pavarur për Media në Kosovës (KPM) është në pritje të miratimit të strategjisë për kalim nga transmetimi analog në transmetimin dixhital në Republikën e Kosovës<sup>8</sup>, në mënyrë që të vazhdojë me fazën e zbatimit të saj.<sup>9</sup>

Është krijuar një opinion që mediat lokale nuk janë më edhe aq të rëndësishme, kur ka mundësi të marrjes së informacionit nga operatorë të ndryshëm dhe në çdo çast në portale. Megjithatë, një hulumtim i audiencës për radiot lokale ka treguar se dëgjueshmëria e radiove lokale është ndjeshëm më e madhe se ajo e radiove nacionale – 60.76% për radiot lokale, në krahasim me 33.54% për radiot nacionale.<sup>10</sup> Gazetaria lokale nuk ka luajtur mirë gjithmonë rolin e saj, por roli që ka ajo është shumë i rëndësishëm.<sup>11</sup> Studiuesi Rasmus Kleis Nielsen, në Institutin Reuters për studime të gazetarisë në Universitetin Oxford në Britani të madhe, thotë se gazetaria lokale ka të ardhme të pasigurt. Këtu theksohet nevoja të ndryshojë formatin dhe mënyrën e punës media lokale, sepse ndryshimet teknologjike dhe platforma të shumta në internet e bëjnë të pamundur funksionimin klasik të saj. Është më interes për njerëzit të njohin ambientin e afërt ku jetojnë. –Qytetin e bën një të tërë vetëm informacioni që vjen nga mediat lokale,...”, vlerëson profesor Artan Fuga.<sup>12</sup> Boyd thotë se –toriet” gazetareske mund të kenë ndikim te

<sup>8</sup> KPM, (<http://www.kpm-ks.org/?mod=njoftimet&id=892&gjuha=1>)

<sup>9</sup> Ligji për dixhitalizimin e transmetimeve radiodifuzive tokësore, 05/L-027

<sup>10</sup> Instituti i Medias i Kosovës, Rrjeti i Radiove Lokale, (<http://imk-ks.org/sq/2010/06/local-radio-network/>)

<sup>11</sup> Kleis Nielsen, Rasmus. Local Journalism-The Decline of Newspapers and the rise of digital media. Londër. 2015. f. 2

<sup>12</sup> Fuga, Artan. “ Nevoja për media lokale”, opinion, botuar në Albeu, (<http://ëëë.albeu.com/opinion/artan-fuga/nevoja-per-media-lokale/34090/>)

publiku vetëm në qoftë se janë të rëndësishme. Për të qenë të rëndësishme ato duhet të kenë afërsinë. Problemi më i madh për ~~ta~~ është më pak i rëndësishëm se sa problemi më i vogël për ~~ne~~.<sup>13</sup>

### **Përfundim**

Gazetaria lokale duhet të zhvillohet më ndryshe në Kosovë. Pavarësisht krizës financiare që mund të ketë media lokale, me një rishikim të investimit dhe të ndryshojë formatin e punës. Hyrja në platformën dixhitale është një obligim ligjor për mediat, edhe ato lokale. Kjo do të jetë një sfidë e madhe për mediat lokale, duke marrë parasysh kapacitetet financiare që kanë tani.

Me procesin e dixhitalizimit duhet të harmonizohen paralelisht edhe ligjet për të drejtat e autorit,<sup>14</sup> në mënyrë që të mbrohet puna dhe produktet e së cilës media, sepse kjo e drejtë është e sanksionuar edhe me Kodin Penal.<sup>15</sup> Kështu krijohet besueshmëri më e madhe në një media dhe rrjedhimisht edhe ekzistenca e saj bëhet më e qëndrueshme. Megjithatë, mbetet të hulumtohet më tej në qoftë se një media lokale në Kosovë mund të funksionojë dhe të bëjë punë të pavarur, për shkak të gjendjes financiare dhe varësisë që krijon nga subjekte të caktuara.

---

<sup>13</sup> Boyd, Andrew. Broadcast Journalism: techniques of radio and television nëës. 5<sup>th</sup> edition. Londër: Elsevier, 2001.f.19.

<sup>14</sup> Ligji Nr. 04/L-065 për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta

<sup>15</sup>Strategjia kundër Piraterisë dhe Falsifikimit,  
(<http://autori-ks.com/?page=1,17#WFFROuYrLIU>)



### Literatura

- Boyd, Andrew. Broadcast Journalism: techniques of radio and television news. 5<sup>th</sup> edition. Londër: Elsevier, 2001.f.19.
- Crow, Andreë. To survive today's media business, local stations need more than ratings, Visioncritical, 2016
- Fuga, Artan. " Nevoja për media lokale", opinion, botuar në Albeu, (<http://www.albeu.com/opinion/artan-fuga/nevoja-per-media-lokale/34090/>)
- IREX. The Development of Sustainable Independent Media in Europe and Eurasia, 2013,
- Kleis Nielsen, Rasmus. Local Journalism-The Decline of Newspapers and the rise of digital media. Londër. 2015.
- Komisioni i Pavarur për Media,
- Ligji për dixhitalizimin e transmetimeve radiodifuzive tokësore, 05/L-027
- Ligji Nr. 04/L-065 për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përfaqëtarëve
- Strategjia kundër Piraterisë dhe Falsifikimit,
- (<http://autori-ks.com/?page=1,17#.WFFROuYrLIU>)